



Sistem Manaxhimi Financiar

Përmirësimi i performancës së kompanive

Prezantim

MyFinance, Platformë Manaxhimi Financiar e ofruar nga MC Networking



Përmbledhje

Prezantim	3
Avantazhet e sistemit MyFinance krahasuar me sisteme të ngjashme në Shqipëri:	4-5-6
MODULET BAZË	7
1. Manaxhim Asetesh	7
2. Qendra Kostosh (QK)	8
3. Planifikim Burimesh (Prodhimi)	9
4. Kontabilitet me skenare kontabël të automatizuar	10
Ndarje kontabiliteti për qendër kostoje (QK)	11
Datasheet për sistemin My Finance	12
1. Konfigurim Bazë	13
Konfigurim i sistemit te adresimit	13
Konfigurim i personave	13
Konfigurim i njësive matëse	13
Konfigurim i kompanisë	13
Konfigurim i komunikimit	13
Konfigurim financiar	14
Konfigurim i transaksioneve	14
2. Administrim Bazë	15
Administrimi i kompanisë	15
Administrimi i Aksesit	15
3. Manaxhimi Financiar	16
Dokumentat Financiar	16
Produktet/Shërbimet	16
Dashboardi i shitjeve	17
Dashboardi i TVSH.....	18
Dashboardi i raportimit	19
Dashboardi i real-time	20

Prezantim

► **MyFinance**, është një sistem manaxhimi financiar për kompanitë e vogla, të mesme dhe të mëdha. Duke u bazuar në eksperiencën që kompania MCN ka me mbi 2000 biznese, ky sistem është ndërtuar aq dinamik sa mund të përshtatet në çdo lloj fushe dhe veprimtarie financiare. Me anën e këtij sistemi mund të zgjidhni aplikimin në fusha si manaxhimi financiar, prodhimi, magazinimi, manaxhimi i shërbimeve, marrëdhëniet me klientin si dhe një platformë e gjerë që mund të përdoret për analizim dhe raportim të detajuar të aktivitetit.

► Sistemi mund të konfigurohet në përputhje me kërkesat ekzakte të biznesit dhe të përshtatet me veprimtarinë e proceseve dhe procedurave që aktualisht biznesi përdor, duke i lejuar përdoruesve të tij një fleksibilitet të lartë në analizë dhe punë të thjeshtuar në mbajtjen e kontabilitetit financiar.

► **MyFinance**, e disponueshme si në arkitekturën client-server ashtu dhe në thin-client, funksionon për windows dhe mund të manaxhoj bazën e të dhënave në databazë relacionale (MS SQL Server 64-bit).


► Kompania MCN pas një eksperience 7 vjeçare duke analizuar punën e shumë klientëve të saj mbi sistemet financiare që aktualisht përdoren në Shqipëri, vendosi të investojë në ndërtimin e një sistemi të tillë në menyrë që puna dhe proceset e punës të një biznesi të thjeshtohen, si dhe gjithashtu fokusi i kompanive të kalojë nga niveli i hedhjes së të dhënave në nivelin e analizës financiare.

AVANTAZHET E SISTEMIT MYFINANCE KRAHASUAR ME SISTEME TË NGJASHME NË SHQIPËRI:

■ Sistem dinamik



■ Sistem modular



■ Sistem i sigurt



■ Sistem i konfigurueshëm për të importuar të dhëna nga sisteme të tjera

■ Sistem me kontroll mbi raporte në kohë reale nga Web dhe/ose SmartPhone



1. Sistem Dinamik

Sistemi është i ndërtuar me një databazë dinamike dhe lejon konfigurimin e çdo lloj veprimtarie financiare nga vetë përdoruesi. Ky sistem lejon që të përshtasësh mënyrën dhe procedurat e punës së përdoruesit. Për çdo shtesë që përdoruesi kërkon në nivelin e elementeve të ruajtjes dhe mbajtjes së të dhënave, përdoruesi ka të drejtë të shtojë dhe të organizojë çdo modul sipas informacioneve që ai dëshiron të mbajë dhe të punojë me këto.

2. Sistem modular

MyFinance është aktualisht i ndërtuar mbi një sërë modulesh të cilat ndërveprojnë me bazën për të regjistruar çdo informacion në sinkron me logjikën bazë financiare. Përveç moduleve bazë, kompania jonë po punon vazhdimisht në shtimin e moduleve të tjera të cilat janë të nevojshme.

3. Sistem i sigurt

Ky sistem ka një nivel shumë të lartë sigurie pasi çdo veprim është i ruajtur dhe çdo element që fshihet

nga sistemi, është sërish i ruajtur në bazën e të dhënave, duke garantuar për përdoruesin që asgjë nuk fshihet. Të gjitha veprimtaritë financiare nuk mund të anulohen, por mund të bëhen veprimet e kundërta që lejojnë rregullimin e veprimtarisë financiare. Të gjitha këto standarde të sigurisë janë bazuar aktualisht në standardet globale që përdorin sistemet më të mëdha financiare për sigurinë e të dhënave.

4. Sistem i konfigurueshëm për të importuar të dhëna nga sisteme të tjera

Sistemi mund të importojë të dhëna nga sisteme të ndryshme financiare që aktualisht përdoren në Shqipëri.

5. Sistem me kontroll mbi raporte në kohë reale nga Web dhe/ose SmartPhone

Sistemi ka një set me Dashbord-e Raportuese dhe Raporte Financiare të cilat mund të aksesohen për të monitoruar në kohë reale Arkën, Bankën, Shitje, Blerje, Inventare etj.



- **Kursimi i burimeve hardware:** kompjuterave client, nuk u nevojiten parametra të lartë për hardware pasi procesimi i sistemit bëhet në server.
- **Databaza** – Baza e të dhënave të MyFinance është në një DB-SQL që bazohet në një motor fortësisht të integruar dhe modern. E menduar që në origjinë për nevojat aktuale të manaxhimit të të dhënave, kjo databazë është konceptuar në mënyrë dinamike që çdo ndryshim që vjen si pasojë e ecjes në kohë, të jetë lehtësisht i përshtatshëm nga ky sistem. Rezultati është një sintezë transparente e funksionaliteteve të avancuara bazuar dhe me potencialin tradicional të databazave, duke rritur kështu fleksibilitetin dhe performancën në sistem. Falë ndërfaqeve të Microsoft Visual Studio 2010 Telerik, të vetive multimediale, të karakteristikave tipike të databazave të mëdha dhe të suportit multi-platform, MyFinance integron funksionet multimediale më të avancuara me ato më tradicionale, për një sistem komfort të nevojave dhe mundësive të biznesit dhe me përdorim të thjeshtë.
- **Ky sistem** është programi ideal për kompanitë e vogla, të mesme dhe të mëdha që u duhet të zgjidhin problematika, qoftë dhe komplekse, lidhur me kontabilitetin e përgjithshëm dhe atë analitik, manaxhim klientësh dhe furnitorësh, magazinimin, prodhimtarinë etj.
- **MyFinance** është një zgjidhje fleksibël, e plotë, e re, por mbi të gjitha e besueshme dhe e sigurt. Struktura fleksibël dhe e integruar e aplikimit lejon kompaninë të implementojë vetëm modulet për të cilat ajo ka nevojë.

Me rritjen e kompleksitetit të aktiviteteve të kompanisë dhe rritjen e kërkesave të saj, është e mundur integrimi i moduleve "custom" për kompaninë.

SISTEMI MBULON:

- ✓ Procese të manaxhimit të kompanisë.
- ✓ Përgjigje sa më fleksibël për çdo kërkesë të çdo kompanie.
- ✓ Mundëson dhe informacionet statistikore të nevojshme për të marrë vendime strategjike.
- ✓ Mundëson manaxhimin njëkohësisht të disa kompanive dhe të disa veprimtarive.

1. Manaxhim Asetesh

- **Mbajtja e Kartelave për çdo Aset**
Sistemi mundëson kategorizimin, vendosjen e tipeve dhe informacionin që duhet të ruhet për çdo ASET në mënyrë dinamike nga vetë përdoruesit.
- **Mbajtja e disa librave amortizimi për çdo aset**
Sistemi ofron mbajtjen e disa librave amortizimi për asetet të cilat lejojnë llogaritjet e amortizimit për çdo aset me metoda të ndryshme, si dhe për llogaritje automatike e amortizimeve për çdo libër amortizimi dhe gjenerimi i ditarëve për t'u postuar në kontabilitet.
- **Shpërndarje sipas Qendër Kostoje të aseteve**
Shpërndarja e Aseteve për Qendër Kosto nënkupton përcaktimin e vendndodhjes së asetit dhe gjithashtu mundëson kalimin automatik të shpenzimeve të asetit për qendër kostoje.

2. Qendra Kostosh (QK)

- Manaxhimi i magazinave dhe vendndodhje si QK**
 Magazinat apo Pikat e Shitjes në sistem janë të konfiguruar të sillen si Qendra Kostosh, duke patur mundësinë që të kontrollohen kostot, të ardhurat dhe shpenzimet për secilën prej tyre.
- Kompani, Arkë, Bankë si QK**
 Sistemi lejon mundësinë e realizimit të analizave mbi arkën, bankën apo QK (të trajtuara si arka unike) duke u bazuar në analiza ditore, mujore, vjetore apo për një periudhë të përcaktuar nga përdoruesi.
- Organizimin e pikave të shitjes si QK më vete**
 Pikat e shitjes apo magazinat trajtohen si qendra kostosh të cilat kanë arkat, shpenzimet, të ardhurat apo mallrat stok dhe asetet specifike.
- Analiza e Shitjeve, Blerjeve dhe transferimeve për QK**
 Sistemi realizon ndarjen e faturave të shitjes, blerjes apo transferimit të produkt/shërbimeve apo hyrjeve/daljeve të vlerave monetare, sipas QK për të analizuar ecurinë në kohë të secilës prej tyre.
- Analiza të Profit & Loss për çdo QK**
 Sistemi mundëson paraqitjen e pasqyrave të të ardhurave dhe shpenzimeve për çdo Qendër Kosto për periudha të zgjedhura nga përdoruesi.



3. Planifikim Burimesh (Prodhimi)

- Organizimi i burimeve të shërbimeve dhe produkteve**
 Sistemi ofron mundësinë që të krijoj shërbime apo produkte të kombinuara nga produktet e thjeshta. Këto shërbime/produkte mund të trajtohen si produkte bazë duke patur mundësinë e vendosjes së çmimeve të shitjes sipas kategorive, tipeve apo klientëve specifik.
- Parashikimi dhe ndjekja e burimeve për çdo shërbim**
 Sistemi ofron mundësinë e konsultimit me përbërësit (shërbimet apo produktet) bazë gjatë krijimit të ofertave të cilat përmbajnë produkte apo shërbime të kombinuara.
- Manaxhimi i kontratave dhe gjenerimi automatik i faturave që rrjedhin nga kontrata specifike**
 Sistemi mundëson gjenerimin e faturave të shitjes apo prokurimeve nga kontratat, apo ofertat e hedhura në sistem. Gjatë konsultimit me kontratat mund të filtrosh sipas kontratave të cilat janë pranë afatit të pagesës dhe më pas të gjenerosh fatura mbi këto kontrata.



4. Kontabilitet me skenare kontabël të automatizuar

■ Konfigurim Transaksionesh kontabël

Për çdo veprimtari ekonomike sistemi lejon të krijosh apo konfigurosh transaksione kontabël të tipeve të ndryshme.

■ Konfigurim Dokumenta Financiar (fatura, kontrata, ditare)

Sistemi lejon krijimin e faturave, kontratave apo ditarëve që janë të tipeve të ndryshëm dhe përdoren për veprimtari ekonomike të specifikuar brenda kompanisë.

■ Krijim dhe konfigurim i skenareve kontabël për çdo veprimtari ekonomike

Sistemi lejon konfigurimin e skenareve të ndryshëm kontabël për tipe transaksionesh të ndryshme. Parakonfigurimi i skenareve të postimit në GL, i jep mundësi sistemit që dokumentat financiar si faturat apo ditarët të postohen automatikisht në plan kontabël sipas skenarit kontabël të përcaktuar nga përdoruesi. Ky avantazh e bën sistemin të përshtatshëm me ndryshimet në legjislacionin fiskal, ndryshime në standardet e përgjithshme kontabël apo detajimet e mëvonshme të GL nga ana e kompanisë.

Ndarje kontabiliteti për qendër kostoje (QK)

- Sistemi lejon mundësinë e realizimit të analizave të planit kontabël në nivel QK Dashboard për Veprimtarinë Financiare

Qendrat e Kostos shërbejnë si dimensionë për analizën e detajuar të kontabilitetit. Në të gjitha veprimtaritë ekonomike që shoqërohen me dokumenta financiar, rakordimi i Qendrave të Kostove i jep mundësinë përdoruesit të krijojë lidhjen e përkatësisë së veprimit ekonomik me qendrën e kostos përkatëse. Ky funksionalitet është shumë i domosdoshëm në raportim, pasi i jep mundësinë përdoruesit të analizojë më tepër të ardhurat dhe shpenzimet për QK por dhe bilancin e çdo QK-je.



Datasheet për sistemin MyFinance

1. Konfigurimi Bazë

1. KONFIGURIM BAZË

- ▶ KONFIGURIMI I SISTEMIT TË ADRESIMIT
- ▶ KONFIGURIMI I PERSONAVE
- ▶ KONFIGURIMI I NJËSIVE MATËSE

KONFIGURIMI I KOMPANISË

- ▶ KONFIGURIMI INSTITUCIONAL
- ▶ KONFIGURIMI I PERSONELIT
- ▶ ORGANIZIMI I AMBJENTEVE

KONFIGURIMI I KOMUNIKIMIT

- ▶ KONFIGURIMI I DOKUMENTAVE
- ▶ KONFIGURIMI I PROTOKOLLIT
- ▶ KONFIGURIMI I E-MAIL
- ▶ KONFIGURIMI I PROCESEVE

KONFIGURIMI I AKSESIT

- ▶ KONFIGURIMI I PËRDORUESVE

KONFIGURIM FINANCIAR

- ▶ KONFIGURIMI I PLANIT TË LLOGARIVE
- ▶ KONFIGURIMI I QENDRAVE TË KOSTOS
- ▶ KONFIGURIMI I KLIENT/ FURNITOREVE
- ▶ KONFIGURIMI I PRODUKTEVE
- ▶ KONFIGURIMI VAT POSTING GROUP
- ▶ KONFIGURIMI I DOKUMENTAVE FINANCIAR

KONFIGURIMI I TRANSAKSIONEVE

- ▶ KONFIGURIMI I VEPRIMTARISË SË TRANSAKSIONEVE
- ▶ KONFIGURIMI VEPRIMTARISË SË FATURAVE
- ▶ KONFIGURIMI I GRUPEVE TË POSTIMIT
- ▶ KONFIGURIMI I PLOTËSIMIT TË TRANSAKSIONEVE

2. ADMINISTRIM

ADMINISTRIM BAZË

- ▶ ADMINISTRIMI I SISTEMIT TË ADRESIMIT
- ▶ ADMINISTRIMI I PERSONAVE
- ▶ ADMINISTRIMI I NJËSIVE MATËSE
- ▶ ADMINISTRIMI I KOMPANISË

ORGANIZIMI KOMPANISË

- ▶ ORGANIZIMI I PERSONELIT
- ▶ ORGANIZIMI I AMBJENTEVE
- ▶ ADMINISTRIMI I AKSESIT

PËRDORUESIT

- ▶ PËRDORUES/FJALËKALIM
- ▶ PËRDORUES/MENU
- ▶ PËRDORUES/AKSES

3. MANAXHIMI FINANCIAR

MONEDHAT

KURSE KËMBIMI

PLANI I LLOGARIVE

DOKUMENTAT FINANCIAR

- ▶ Arkë/Bankë
- ▶ Shitje
- ▶ Blerje
- ▶ Transferim
- ▶ Journal
- ▶ Kontrata
- ▶ Oferta

KONFIGURIM I TEMPLATE

KLIENT/FURNITORË

QENDRAT E KOSTOS

PRODUKTET/SHËRBIMET

- ▶ PRODUKTE/SHËRBIME PËR SHITJE
- ▶ PRODUKT/SHËRBIME-NJËSI/PERIODICITET
- ▶ PËRDORUES/DOKUMENTA FINANCIAR

4. RAPORTIM

PASQYRA FINANCIARE

- ▶ INVENTAR-ASETE
- ▶ PASQYRA FINANCIARE
- ▶ PASQYRA TË ARDHURA-SHPENZIME
- ▶ DITARI I LLOGARIVE
- ▶ TRIAL BALANCE
- ▶ REGJISTRI I VAT
- ▶ PLANI I LLOGARIVE

DITARKLIENT - FURNITOR

- ▶ ANALIZË LLOGARIE
- ▶ ANALIZË KLIENT
- ▶ ANALIZË QENDËR KOSTO
- ▶ GJENDJE INVENTARI
- ▶ TRANSFERIM INVENTARI
- ▶ ANALIZË CMIMI
- ▶ GJENDJE ASETE
- ▶ AMORTIZIM ASETE
- ▶ RIVLERËSIM ASETE ME KURS FUND MUAJI
- ▶ GJENDJE CHART

RAPORTE MANAXHERIALE

- ▶ GJENDJE MALLRASH PËR QENDËR KOSTO
- ▶ GJENDJE ASETE PËR QENDËR KOSTO
- ▶ SHITJE PËR QENDËR KOSTO
- ▶ BLERJE PËR QENDËR KOSTO
- ▶ SHITJE PËR KLIENT
- ▶ BLERJE PËR FURNITOR
- ▶ ANALIZË FURNITOR

■ KONFIGURIMI I SISTEMIT TË ADRESIMIT

Në këtë panel ju mund të konfiguroni parametrat për sistemin e adresimit që dëshironi të organizoni në sistem, këtu mund të bëhet ndarja e njësive administrative si qytete, rrethe, prefektura, bashki, komuna etj.

■ KONFIGURIMI I PERSONAVE

Ky konfigurim përfshin vendosjen e vetive që do përdoren për të ruajtur të dhënat personale të çdo individi të regjistruar në sistem, më mbrapa këta individë mund të jenë ose jo personel apo përdorues të sistemit.

■ KONFIGURIMI I NJËSIVE MATËSE

Konfigurimi i njësive matëse shërben për të paracaktuar tipet e njësive matëse që do përdoren në sistem për secilën kategori produktesh ose shërbimesh.

■ KONFIGURIM I KOMPANISË

• KONFIGURIMI INSTITUCIONAL

Konfigurimi Institutional shërben për të bërë ndarjen e njësive bazë në të cilat ndahet kompania. Është gjerësisht i përdorur në rastin e institucioneve publike dhe private të cilat janë të ndara në godina apo ambiente të ndryshme.

• KONFIGURIMI I PERSONELIT

Të gjitha vetitë që ruhen për personelin si shembull: kualifikimet, trajnimet, eksperiencia, etj, mund të konfigurohen në varësi të nevojave të biznesit. Ky panel i shërben modulit të HR por dhe përdoruesve në sistem.

• ORGANIZIMI I AMBJENTEVE

Organizimi i ambienteve i lejon përdoruesit të bëjë ndarjen funksionale ku ai do të regjistrojë ambientet e kompanisë si dhe varësinë e mundshme që mund të kenë ambientet.



• KONFIGURIMI I PLANIT TË LLOGARIVE

Në këtë panel konfigurohen kategoritë, tipet dhe vetitë që do përdoren për llogaritë e planit kontabël për biznesin përkatës.

• KONFIGURIMI I QENDRAVE TË KOSTOS

Në këtë panel mund të konfigurohen të gjitha qendrat e kostos të kompanisë. Qendrat e kostos përfshijnë: magazinat, pikat e shitjes, zyrat administrative, arkat etj. Për secilën prej tyre mund të përcaktohen vetitë që përdor secila si dhe lidhjet me elemente të tjera të sistemit.

• KONFIGURIMI I KLIENT/FURNITORËVE

Në këtë panel mund të konfigurohen klientët dhe furnitorët e kompanisë. Për secilin prej tyre mund të përcaktohen vetitë që mbartin klientët duke i ndarë ata në kategori dhe tipe, si dhe gjithashtu për furnitorët. Kjo i lejon përdoruesit ndarjen e klientëve dhe furnitorëve në varësi të analizës që ai dëshiron të bëjë më mbrapa në varësi të kategorive apo tipeve të klientëve dhe furnitorëve.

• KONFIGURIMI I PRODUKTEVE

Konfigurimi i produkteve është në të njëjtën logjikë me konfigurimin e planit të llogarive. Por ndryshe nga kjo, ky panel të lejon të krijosh kategoritë bazë të produkteve që janë: Produkte, Shërbime dhe Asete. Përdoruesi në bazë të këtij paneli mund të organizojnë produktet dhe llojet e të dhënave që ruhen për secilin në mënyrë manuale dhe automatike në saj të funksionalitetit që ka të bëjë me veti të përgjithshme dhe veti specifike.

• KONFIGURIMI VAT POSTING GROUP

Në këtë panel konfigurohen llojet e TVSH-ve që përdoren në faturat e sistemit. (0%, 10%, 20%)



• KONFIGURIMI I DOKUMENTAVE FINANCIAR

Një ndër panelet që lidhet direkt me bërthamën e këtij sistemi, është paneli i konfigurimit të dokumentave financiar. Me anën e këtij paneli, përdoruesi mund të krijojë çdo lloj dokumenti financiar që ai e shoqëron me një veprimtari financiare. Duke qënë një sistem dinamik, përdoruesi mund të ndryshojë me kalimin e kohës llojet e dokumentave financiar që ai përdor. Në sistem aktualisht janë të konfiguruar me anë të kësaj menuje dokumentat bazë të ndara në kategoritë: Shitje, Blerje, Arkë/Bankë, Transferime Malli, Kontrata, Oferta, Ditare, etj.

• KONFIGURIMI I VEPRIMTARISË SË FATURAVE

Për çdo dokument financiar kemi konfigurimin e shitësit (Nga), Blerësit (Ku), dhe Transaksionin (Çfarë). Konfigurimi i këtyre elementëve është i domosdoshëm në përcaktimin e veprimtarisë së dokumentave financiare.

■ KONFIGURIMI I TRANSAKSIONEVE

• KONFIGURIMI I VEPRIMTARISË SË TRANSAKSIONEVE

Veprimtaria e transaksioneve kërkon një konfigurim për çdo tip apo kategori transaksionesh, në mënyrë që të përcaktohet për secilin transaksion, në cilin element logjik të sistemit do i marri të dhënat. Transaksionet janë të ndara në varësi të dokumentave financiar, dhe me anën e këtij paneli mund të krijosh dhe të shpërndash lloje transaksioni të ndryshme për dokumenta financiar të ndryshëm.

• KONFIGURIMI I GRUPEVE TË POSTIMIT

Në këtë panel ndërtohen të gjithë skenarët kontabël të integritetit të planit të llogarive me transaksionin e çdo dokumenti financiar. Përdoruesi mund të konfigurojë logjikën kontabël në varësi të veprimtarisë së biznesit dhe mund ta ndryshojë atë në varësi të ndryshimit të standardeve të përgjithshëm kontabël nëse ato ndryshojnë, kjo vlen si për SPK (NAS) dhe për IFRS.



2. Administrim Bazë

• ADMINISTRIMI I SISTEMIT TË ADRESIMIT

Në këtë panel mund të hidhen të gjitha njësitet dhe elementet e sistemit të adresimit në varësi të vetive dhe konfigurimit që është bërë në sistemin e adresimit.

• ADMINISTRIMI I PERSONAVE

Në këtë panel mund të shtohen, fshihen, modifikohen të gjithë personat e regjistruar në sistem. Përdoruesi mund të regjistrojë të gjitha të dhënat personale që ka konfiguruar tek njësitet e tij.

• ADMINISTRIMI I NJËSIVE MATËSE

Krijimi, editimi dhe vendosja e njësive matëse. Për çdo njësi matëse këtu mund të plotësohen vetitë përkatëse që janë konfiguruar për çdo njësi.

■ ADMINISTRIMI I KOMPANISË

• ORGANIZIMI I KOMPANISË

Këtu bëhet krijimi i elementëve që përbëjnë kompaninë, për kompaninë bazë këtu mund të hapen njësitet të cilën e përbëjnë këtë kompani.

• ORGANIZIMI I PERSONELIT

Në këtë panel mund të shtohen, fshihen, modifikohet i gjithë personeli i regjistruar në sistem. Përdoruesi mund të regjistrojë të gjitha të dhënat e personelit që ka konfiguruar tek vetitë e tij.

• ORGANIZIMI I AMBJENTEVE

Për secilën njësi të kompanisë këtu mund të krijohen dhe të vendoset varësia e ambjenteve që ka në dispozicion biznesi.

■ ADMINISTRIMI I AKSESIT

• PËRDORUESIT

Në këtë panel mund të shtohen, fshihen, modifikohen të gjithë përdoruesit e regjistruar në sistem.

• PËRDORUES/FJALËKALIM

Vendosja e fjalëkalimit për çdo përdorues.

• PËRDORUES/MENU

Vendosja e të drejtave për çdo rol përdoruesi mbi menutë që përdoruesi ka të drejt të hapi.





3. Manaxhimi Financiar

1. DASHBOARD-I I SHITJEVE

2. DASHBOARD-I I TVSH

3. DASHBOARD-I I RAPORTIMIT

4. DASHBOARD-I REALTIME

MONEDHAT

Këtu mund të krijohen monedhat që përdoruesi punon në sistem.

KURSE KËMBIMI

Këtu mund të vendosen kurset për çdo datë, për çdo monedhë.

PLANI I LLOGARIVE

Në këtë panel mund të shtohen, fshihen, modifikohen të gjithë llogaritë kontabël, (GL Account) e regjistruara në sistem.

■ DOKUMENTAT FINANCIAR

- **Arkë/Bankë:** Paneli ku mund të hedhësh mandatet e arkëtimit apo pagesa si dokumenta financiar të krijuar për kategorinë e arkës/bankës.

- **Shitje:** Paneli ku mund të hedhësh faturat e shitjes si dokumenta financiar të krijuar për kategorinë e shitjes.

- **Blerje:** Paneli ku mund të hedhësh faturat e blerjes si dokumenta financiar të krijuar për kategorinë e blerjes.

- **Transferim:** Paneli ku mund të hedhësh transferimet që përfshijnë hyrje, dalje dhe të gjitha lëvizjet e mallrave nëpër qendra kostosh.

- **Journal:** Tek kjo kategori janë ditaret kontabël me anën e të cilave mund të bëhen të gjitha regjistrimet kontabël në llogaritë përkatëse.

- **Kontrata:** Në këtë panel janë dokumentat financiar të tipit kontratë. Me anë të kontratës mund të fiksohen fatura periodike të cilat rrjedhin nga një kontratë. Në këtë mënyrë me anë të kontratës mund të gjenerohen detyrimet që përcaktohen në kontratë si fatura shitje apo blerje në sistem.

- **Oferta:** Paneli ku mund të krijosh ofertat si dokumenta financiar, por që postimi i ofertës nuk ndikon në procesimin kontabël në sistem.

KONFIGURIM I TEMPLATE

Paneli ku mund të konfigurohen template-et për faturat e ndryshme.

KLIENT/FURNITORË

Krijimi, editimi dhe plotësimi i Furnitorëve dhe Klientëve me të dhënat e tyre përkatëse.

QENDRAT E KOSTOS

Krijimi, editimi dhe plotësimi i Qendrave të Kostos në sistem me të dhënat e tyre përkatëse.

■ PRODUKTET/SHËRBIMET

• PRODUKTE/SHËRBIME PËR SHITJE

Në këtë panel mund të manaxhohen kartelat e çdo artikulli, shërbimi dhe aset, duke u konsultuar me të dhënat bazë të tyre, si dhe me faturat e blerjes nga të cilat janë blerë dhe faturat e shitjes me të cilat janë shitur. Në këtë panel jepet gjithashtu një inventar i të gjitha produkteve me sasi të përkatëse dhe qendrat e kostos ku ndodhen këto produkte. Ky panel shërben gjithashtu për vendosjen e çmimeve, i cili mund të konfigurohet edhe në varësi të kategorisë apo tipit të klientit.

- **PRODUKT/SHËRBIME-NJËSI/PERIODICITET**
Në këtë panel bëhet bashkangjitja e artikujve, shërbimeve dhe aseteve me njësitë përkatëse të matjes.

• PËRDORUES/DOKUMENTA FINANCIAR

Në këtë panel përcaktohet se kush përdorues mund të aksesoj secilin dokument financiar të krijuar në sistem. Janë implementuar 4 dashboard-e që japin informacion me plotësimin e grafikëve të ndryshëm dhe me tabela për të dhëna specifike.

DASHBOARD-I I SHITJEVE

- Për kohën midis dy datave të zgjedhura nga përdoruesi, dashboard-i ofron informacion me anë të grafikëve për:
 1. Shitje-blerje total në raportin datë/vlerë
 2. Shitje-blerje për qendër kostoje në raportin Qendër Kosto / Vlerë
 3. Shitje për tip produktesh
 4. Blerje për tip produkti.
- Po në të njëjtën kohë që zgjidhet në hapjen e dashboard-it, informacioni që afishohet në grida të ndryshme është mbi :
 1. Vlerën e xhiros së bërë për tipe të ndryshëm klientësh
 2. Vlerën e shpenzimit të bërë për furnitorët e ndryshëm
 3. Shitjen/blerjen për secilën qendër kostoje që është e lidhur me MyFinance

DASHBOARD-I I RAPORTIMIT

- Dashboard-i i raportimit ofron informacion grafik mbi :
 1. Vlerën e faturave të hyrjes dhe atyre të daljes
 2. Ecurinë e top 4 produkteve më të shitura
 3. Ecurinë e top 4 kombinimeve më të shitura
 4. Ecurinë në vlerë të 4 produkteve më të shitura në secilën nga pikat e lidhura me sistemin.
- Përveç informacionit grafik ofrohet dhe informacion tabelar për:
 1. Shitjen, blerjen dhe fitimin bruto për çdo pikë shitje
 2. Vlerën e xhiros së kryer nga secili kamarier në secilën pikë

DASHBOARD-I I TVSH

- Gjithashtu edhe në këtë dashboard informacioni jepet si me anën grafike dhe me atë tabelore. Dashboard-i ofron informacion për TVSH-në në hyrje dhe atë në dalje me mënyrë grafike , ofron informacionin për grupet e produkteve të shitur brenda datave të zgjedhura në hyrje, shitjen në kombinim me qendrat e kostos dhe numrin e klientëve.

DASHBOARD-I I REAL-TIME

- Ky dashboard ofron mbikqyrjen e veprimtarisë në kohë reale për çdo pikë të lidhur në sistem.

Pas zgjedhjes së pikës së shitjes afishohen të renditura me rend kohor faturat e printuara nga POS-et. Në mënyrë të paracaktuar vetë-zgjidhet fatura e fundit e printuar , nëse dëshirohet info mbi një tjetër faturë atëherë mjafton klikimi mbi rreshtin e dëshiruar. Pas këtij veprimi jepet në mënyrë grafike :

1. Vlerat që kishin secili nga produktet e shitur në këtë faturë
2. Totali i grupuar për secilin nga 20 produktet më të shitur
3. Kombinimi emërtim/vlerë për 10 faturat e fundit

- Secili nga këto dashboard-e mban në ndërfaqen e përdoruesit kontrollorin e nevojshëm për të modifikuar kohën e rifreskimit të të dhënave. Kjo kohë varion nga 1 në 30 min.



MyFinance ofron:

MultiFunksional : Një Sistem Dinamik, modular, i sigurt dhe të integruar me sinkronizim të POS.

Kontrollues : Një Sistem me kontroll mbi raporte në kohë reale nga Web dhe/ose SmartPhone.

Me Zgjedhje : Nje sistem që i lejon kompanitë të zhvillojnë mbi këtë sistem të gjitha proceset e punës dhe nevojat që kanë për biznesin e tyre.

MyFinance i lejon bizneset që të zhvillohen drejt suksesit të tyre dhe të jenë më avangardë me konkurrentët.



Financuar dhe ofruar nga:



www.mcn.al